

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7004
E hënë, 25 shtator 2023
Çmimi 0.40

Policia publikon pamjet e
aresnalit të armëve dhe
pajisjeve ushtarake të zëna
në Manastirin e Banjskës

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TERRORISTËT E ARMATOSUR SËRBË NË VERI SULMOJNË POLICINË E KOSOVËS,
NË PËRBALLJE ME TO, VRITET RRESHTERI I POLICISË AFRIM BUNJAKU.
SOT (E HËNË) DITË ZIE NË KOSOVË

RRESHTERI AFRIM BUNJAKU BIE NË MBROJTJE TË SOVRANITETIT TË KOSOVËS

- Akti kriminal në veri dënohet nga Kosova,
Shqipëria dhe bashkësia ndërkombëtare



Rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, është vrarë të dielën në veri të Kosovës gjatë përballjes me forcat e armatosura terroriste serbe. Në ballafaqim me terroristë ka mbetur i plagosur edhe polici Alban Rashiti dhe është

lënduar një tjetër. Policia ka njoftuar se tre sulmues kanë mbetur të vrarë në Banjskë të Zveçanit dhe janë arrestuar gjashtë persona të tjerë. Ky akt kriminal është dënuar nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, partitë

politike dhe bashkësia ndërkombëtare. Ata i kanë shprehur ngushëllime familjes Bujaku dhe kanë kërkuar të ndalen aktet e tilla kriminale. Në nderim të rreshterit Bujaku sot (e hënë) do të mbahet ditë zie në Kosovë

OPINION

GRECIA ËSHTË
'AKTORJA KRYESORE'
E DESTRUKSIONIT
NË RAJONIN TONË

Milazim
KRASNIQI



AKTUALE



KRYEPROKURORI WHITING BRAKTIS
GJYKATËN SPECIALE

BLLOKIMI I BUXHETIT NË SHBA,
BIDENI KRITIKON REPUBLIKANËT
EKSTREMISTË

ETIAS-i NUK DO TË NISË
FUNKSIONIMIN NË VITIN 2024?

HARADINAJ NË LIPJAN: AAK-ja
PO RIKTHEHET FUQISHËM

EKONOMI



KOSTT-I IA KËRCON KUVENDIT
MBI 23 MILIONË EURO PËR
RRYMËN NË VERI

EKSPORTI SHËNON RËNIE MBI
20 PËR QIND, E MBULON IMPORTIN
ME VETËM 12.9 PËR QIND

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji biznesi.com
info@kolegji biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Marrëdhëniet e tensionura Ukrainë - Poloni po shkaktojnë përçarje në BE

VARSHAVË, 24 SHTATOR - Njoftimi i Polonisë se do ta ndalojë furnizimin me armë të Ukrainës pas një konflikti të ashpër mbi ndalimin e importeve të produkteve bujqësore ukrainase vazhdon të jetë i madh, megjithëse Varshava duket se është tërhequr.

“CNN” është përpjekur ta paraqesë situatën në kampin e Bashkimit Evropian (BE) ku duket se ka një “krisje” për mbështetjen për Kievin, ndërkohë që lufta në Ukrainë vazhdon. Mediumi i njohur amerikan ka kujtuar se Polonia ishte një nga aleatët më të afërt të Kievit deri në shpërthimin e krizës aktuale.

Pas këtij zhvillimi, siç është theksuar në analizën e “CNN”-it, ngrihen një sërë pyetjesh, më e rëndësishmja prej të cilave është nëse vendosmëria e palëkundur e Evropës përballë një pushtimi rus në shkallë të plotë do të përfundojë.

Si filloi kriza?

Polonia, Sllovakia dhe Hungaria kanë njoftuar kufizime në importet e drithërave nga Ukraina të premtën pasi Komisioni Evropian ka vendosur të mos zgjasë ndalimin e shitjeve për pesë nga fqinjët evropiane të Ukrainës, të cilët përfshijnë gjithashtu Rumaninë dhe Bullgarinë. Këto vende janë ankuar se gruri i lirë ukrainas po shkatërron tregun e tyre të brendshëm.

Disa javë para zgjedhjeve në Poloni

“CNN”-i ka vërejtur se Polonia është disa javë larg zgjedhjeve kombëtare të 15 tetorit, në të cilat partia në pushtet Ligj dhe Drejtësi (PiS) pritet të pësojë humbje.

Në këtë analizë të veçantë është theksuar se bujqësia është veçanërisht e rëndësishme për politikën evropiane. Gjithashtu, duke theksuar se fermerët kanë një këndvështrim politik, qytetarët priren të kujdesen për sigurinë ushqimore, ndonjëherë në mënyrë disproporcionale dhe irracionale, sipas “CNN”.

Dhe, PiS-i do të ketë nevojë për votat rurale për të qëndruar në pushtet. Kjo shpjegon lëvizjen e qeverisë polake që donte të bënte një gjest nacionalist, i cili do të vinte në qendër të vëmendjes.

Megjithatë, kjo mosmarrëveshje relativisht marginale doli jashtë kontrollit të martën e kaluar, kur Volodymyr Zelensky i ka thënë Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së: “Është shqetësuese të shohësh se disa në Evropë, disa nga miqtë tanë në Europë, po shtiren sikur na duan”. Ndërsa kryeministri polak, Mateusz Morawiecki është përgjigjur në rrjetet sociale duke shkruar: “Ne nuk po dërgojmë më armë në Ukrainë, sepse tani do të armatosim Poloninë”. Varshava më pas është tërhequr nga ai pozicion dhe është zotuar se do të dërgonte armët e premtuara në Ukrainë. Në fakt, presidenti polak, Andrzej



Duda, ka pohuar se fjalët e kryeministrit të vendit të tij janë “interpretuar në mënyrën më të keqe të mundshme”.

Fermerët polakë dhe hyrja e Ukrainës në BE

Më tutje, “CNN”-i në analizën e tij i referohet asaj se çfarë mund të nënkuptojë kriza aktuale për Ukrainën në planin afatgjatë. Perëndimi aktualisht po bën një përpjekje të madhe për të integruar Ukrainën në institucionet e saj. Vendi po përpiqet të bashkohet si në BE ashtu edhe në NATO, për të cilat ka mbështetje unanime. Megjithatë, kjo mbështetje tashmë vjen me paralajmërime dhe kushte. Shumica e vendeve anëtare të BE-së pranojnë se që Ukraina të anëtarësohet do të duhet një reformë thelbësore në mënyrën se si funksionon BE-ja. Nëse Ukraina do të bashkohej ashtu siç është, shumë nga fondet që aktualisht shkojnë për shtetet anëtare në formën e subvencioneve, duke përfshirë edhe për bujqësinë do të shkonin në Ukrainë. “Përpikuni t’ia shisni atë fermerëve polakë”, ka shkruar CNN. Strukturat aktuale të

BE-së do t’i jepnin edhe anëtarit më të ri ndikim të madh në institucione, përkatësisht parlamentin dhe këshillin e shteteve anëtare. Sa i përket NATO-s, ka anëtarë të aleancës të cilëve nuk u pëlqen ideja që një vend fjalë për fjalë në luftë do të kishte akses në mekanizmin e Nenit 5, i cili parashikon “një për të gjithë dhe të gjithë për një” dhe i shtyn aleatët të mbështesin njëri-tjetrin.

Episodi me Poloninë, ka shtuar analiza e “CNN”-it mund t’u bëjë presion vendeve që vënë në dyshim korrektesinë e vendimeve të Perëndimit për t’i dhënë kaq shumë mbështetje një vendi që nuk është as anëtar i aleancës.

“Dhuratë për Putinin”

Më në fund, zyrtarët në të gjithë Evropën janë të indinjuar pasi ngjarjet e fundit i japin Vladimir Putin një mundësi për propagandë.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, i pyetur për mosmarrëveshjen, e ka përdorur atë për të thënë se “ka tensione të caktuara midis Varshavës dhe Kievit. Ne parashikojmë që këto tensione do të rriten”.

Shumë diplomatë, në fund të fundit, argumentojnë se në luftën e dezinformimit ajo që është e keqe për Perëndimin është e mirë për Rusinë. Konfliktet publike midis vendeve perëndimore e bëjnë më të lehtë argumentimin se Perëndimi është i ndarë dhe një Perëndim i ndarë është sigurisht një gjë e mirë për Kremlinin, ka përfunduar “CNN”-i.

Bllokimi i buxhetit në ShBA, Bideni kritikon republikanët ekstremistë

WASHINGTON, 24 SHTATOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka fajësuar një grup të vogël republikanësh ekstremë për bllokimin buxhetor, teksa i ka kërkuar ligjvënësve të partisë të marrin hapa të menjëhershëm për të parandaluar një mbyllje të qeverisë përpara afatit të 30 shtatorit.

Gjatë një konference, lideri i ShBA-së është shprehur se ai



dhe republikani kryesor i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy kanë rënë dakord më parë për nivelet e shpenzimeve të qeverisë. Sipas tij, çmimi është

i lartë nëse nuk përmbushet marrëveshja. “Të jemi të qartë. Nëse qeveria mbyllet, kjo do të thotë që anëtarët e Kongresit dhe ushtrisë amerikane duhet të vazhdojnë të punojnë dhe të mos paguhen. Mbyllja e qeverisë mund të ndikojë në gjithçka, nga siguria ushqimore, kërkimi i kancerit, programi për fëmijët. Financimi i qeverisë është një nga përgjegjësitë më themelore të Kongresit”, ka thënë Bideni. Ligjvënësit amerikanë kanë afat

deri në mesnatën e 30 shtatorit për të arritur një marrëveshje mbi projekt-ligjin shpenzimeve, përpara se financimi për shërbimet qeveritare të përfundojë.

Nëse gjërat nuk shkojnë siç duhet e gjithë situata do të jetë kosto e konsiderueshme politike për Bidenin, i cili kandidon për të marrë sërish drejtimin e Shtëpisë së Bardhë. Shtëpia e Bardhë dëshiron që çdo projektligj buxhetor i miratuar

nga ligjvënësit të përfshijë 24 miliardë dollarë ndihmë ushtarake dhe humanitare për Kievin. Ndërsa një plan i tillë mbështetet nga demokratët dhe republikanët në Senat, ai kundërshtohet rrënjësisht nga disa anëtarë të Dhomës. Votimi i buxhetit në Kongres kthehet rregullisht në një përplasje midis dy partive, ku secili kamp përdor mundësinë e një mbylljeje për të marrë lëshime nga tjetri, derisa të gjendet një zgjidhje.

Italia do të prodhojë së bashku me Britaninë dhe Japoninë aeroplanë të rinj luftarakë

ROMË, 24 SHTATOR - Italia ka njoftuar se do të jetë partner i barabartë në programin luftarak të gjeneratës së ardhshme me Britaninë e Madhe dhe Japoninë, pasi negociatat e mëtejshme mbi projektin janë duke u zhvilluar, përfshirë ato në selinë e programit.

Të tre vendet krijuan programin global CombatAir (GCAP) në dhjetor, pasi Britania dhe

Japonia, kanë rënë dakord të kombinojnë përpjekjet e tyre luftarake në një bashkëpunim inovativ që synon të disponojë një aeroplan të avancuar deri në mesin e dekadës së ardhshme.

“Reuters”-i ka raportuar se Japonia dhe Britania do të dominojnë projektimin dhe prodhimin, me Londrën që ka më shumë gjasë të udhëheqë organizatën për shkak të përvojës

së saj më të thellë dhe më të fundit në zhvillimin e aeroplanëve luftarakë. “Programi global ‘CombatAir’ ose GCAP, është një program tre-kombëtar i bazuar në parimet e ndarjes së barabartë, siç deklaruan kryeministrat në një deklaratë të përbashkët ministrove dhjetorin e kaluar. Vendimi përfundimtar do të përfshijë një ndarje të barabartë dhe të



balancuar të kostove dhe përfitimeve”, ka thënë Ministria italiane e Mbrojtjes. Po ashtu, “Reuters”-i ka raportuar se vendet partnere

planifikojnë të zgjedhin Britaninë si selinë e tyre. Italia tha se diskutimet mbi këtë çështje po vazhdojnë midis qeverive dhe partnerëve të industrisë.

“Tre ministratë e Mbrojtjes po kryejnë aktualisht kërkime për lidhshmërinë më të mirë për të arritur objektivin deri në vitin 2035”, ka njoftuar Ministria italiane e Mbrojtjes.

ShBA-ja ia kërkon Kurtit një propozim për Asociacionin

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Pas një raundi tjetër të pasuksesshëm të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nga Uashingtoni janë duke ardhur mesazhe për nevojën e një qasjeje të re. Fillimisht ato i janë drejtuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, të cilit i dërguari special amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, i ka bërë thirrje edhe një herë ta ndryshojë qasjen dhe t'i respektojë obligimet e marra. Megjithatë, ka edhe mendime se vetë partnerët amerikanë dhe evropianë duhet ta ndryshojnë strategjinë e tyre, pasi kjo aktuale nuk po jep rezultate.

Është koha për një qasje të re të partnerëve në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka thënë Escobar, duke folur për edicionin serb të "Zërit të Amerikës" në Nju-Jork, ku është takuar me liderët nga rajoni në marginat e sesionit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. "Është koha për një qasje të re të atyre njerëzve që i qasen dialogut me qëndrimin: 'merre ose lere'. Konkretisht e kam fjalën për Qeverinë e Kosovës. Ata e kanë të qartë se cilat janë detyrimet e tyre. Dhe mendoj se deklarata e Josep Borrellit ishte shumë e qartë. Ne vazhdojmë ta inkurajojmë Serbinë të jetë konstruktive dhe e durueshme. Ne vazhdojmë t'i kërkojmë asaj që të mos bëjë asgjë që kontribuon në destabilizimin e Kosovës. Ne duhet të vazhdojmë të punojmë për dialog. Nuk ka alternativë për rajonin, përveç integritetit evropian", është shprehur Escobar.

Një mesazh i ngjashëm ka ardhur nga Kongresi Amerikan. Mike Turner, kongresisti republikan nga Ohajo, i cili së fundmi ka vizituar rajonin, ka vlerësuar për "Zërin e Amerikës" se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duhet t'i përmbushë obligimet e tij lidhur me formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Kur u takova me presidenten e



Kosovës, Vjosa Osmani, e bëra të qartë se duhet progres në aspektin e Asociacionit. Kosova nuk ka paraqitur ende një propozim. Dhe ky është një detyrim që është rezultat i dialogut, me ndërmjetësimin e evropianëve dhe të cilin ShBA-ja e mbështeti, por nuk ishte pjesë e tij. Por ai detyrim u mor dhe kryeministri duhet ta përmbushë dhe të bëjë një propozim, që të paktën njerëzit të shohin se ai nuk është i pasinqertë, që këto bisedime në fakt synojnë zgjidhjen e konfliktit", ka thënë Turner.

Ndërsa analisti dhe profesori në Universitetin "Johns Hopkins", Sinisha Vuković, ka thënë se Kurti është negociator i vështirë për zyrtarët evropianë dhe amerikanë, sepse duke insistuar në zbatimin me faza të marrëveshjeve, ai vendos kushte që nuk ishin paraparë në udhërrëfyesin në periudhën e mëparshme. "Kjo i jep hapësirë presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe autoriteteve serbe, që të jenë në një pozitë shumë më të mirë se Kosova. Edhe pse ata nuk marrin të njëjtin nivel kritikash si

Kosova, dhe duke e parë atë nga ana e negociatave, arsyet janë të thjeshta - ndërmjetësit përvijuan qëllimin dhe strategjinë dhe ata nuk duan të devijojnë nga ajo strategji në momentin që hasin në një mur dhe përpiqen t'ia hedhin fajin njëri nga të dy palët. Mendoj se kjo nuk është e qëndrueshme dhe në një të ardhme të afërt mund të ketë një ndryshim në pozicionimin strategjik të ShBA-së dhe BE-së... Ka një ndërgjegjësim në rritje se ose do të ketë një ndryshim reciprok të qasjes ose ky proces do të dëshmojë se është shumë i rëndë dhe i vështirë për administratën amerikane dhe askujt nuk i pëlqen të japë llogari për dështimin", ka thënë Vuković.

Ai ka theksuar se Kurti udhëhiqet nga vlerësimi i tij se çfarë është në interesin kombëtar të Kosovës dhe se aktualisht nuk ndien presion të brendshëm për ta ndryshuar qasjen e tij. Megjithatë, përpjekjet e Uashingtonit janë të përqendruara pikërisht që kryeministri i Kosovës të pajtohet me përmbushjen e

obligimit për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Gabriel Escobar ka hedhur poshtë kritikën e Prishtinës se i dërguari i Bashkimit Evropian në dialog, Miroslav Lajčak, është i njëanshëm në favor të Serbisë. "Lajčaku gëzon besimin e plotë të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara. Pas kolapsit të bisedimeve, 27 shtete anëtare të Bashkimit Evropian shprehën publikisht mbështetjen e tyre për Lajčakun. Pra, kjo është diçka me të cilën Kurti do të duhet të merret. Lajčaku dhe dialogu nuk do të zhduken. Një vend me një milion e gjysmë banorë nuk do ta bindë komunitetin transatlantik me 700 milionë banorë t'i ndryshojë taktikat e tij", ka thënë Escobar.

Sinisha Vuković ka përkujtuar se qëllimi përfundimtar i ShBA-së dhe vizioni i saj për të ardhmen është njohja reciproke e Kosovës dhe Serbisë, por beson se është zgjedhur një strategji problematike për të arritur rezultate. "Pikërisht për shkak të vendimeve të tilla që u morën dhe taktikave për ta arritur

qëllimin, Serbia u gjend, mbase papritur, dhe ndoshta në mënyrë strategjike, në një pozicion komod për të blerë kohë dhe Serbia shihet si një lloj faktori stabiliteti, të paktën për momentin, të cilën nuk duhet fajësuar shumë, aq sa që - pas marrjes së një lloj kompromisi nga Kosova - t'i kërkohej të bëjë të njëjtën gjë. Serbia mund të blejë kohë në këtë moment, por hapi tjetër është të presim që Serbia të përmbushë çfarë pritet prej saj. Nëse nuk arrihet kjo, vetëm atëherë mund të presim presion serioz dhe ndryshime serioze në marrëdhëniet e Perëndimit me Serbinë", ka thënë ai.

Kongresisti Mike Turner, i cili është edhe kryetar i Komisionit të Dhomës për Punë të Jashtme, ka thënë se beson se administrata e Joe Biden dhe Departamenti Amerikan i Shtetit duhet t'i japin prioritet më të madh zgjidhjes së marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Edhe pse Amerika është duke hyrë në një vit zgjedhor, Sinisha Vuković beson se vëmendja drejt Ballkanit nuk do të ulet, edhe pse nuk është një fokus i hapur si Ukraina apo një pikë nevralgjike si Tajvani. "Në çdo rast, Ballkani zë një nivel të mjaftueshëm dhe, ndoshta, më shumë se kaq, vëmendjeje brenda Departamentit të Shtetit. Mund të shihet niveli nga i cili flasin dhe shpeshësia e atyre mesazheve që vijnë kur bëhet fjalë për Ballkanin. Ajo që mund të befasojë shumë është mungesa e rezultateve dhe, ndoshta, kjo frekuencë mesazhesh është vetëm pasojë e mungesës së rezultateve që pritej deri më tani", ka thënë Vuković. E përderisa politika e kryeministrit të Kosovës aktualisht identifikohet si pengesë për vazhdimin e dialogut, përfaqësuesit e administratës dhe Kongresit edhe një herë i kanë bërë thirrje Serbisë t'i respektojë sanksionet evropiane kundër Rusisë për shkak të pushtimit të saj ndaj Ukrainës.

Kryeprokurori Whiting braktis Gjykatën Speciale

HAGË, 24 SHTATOR - Alex Whiting, i cili në nëntor të vitit të kaluar kishte zëvendësuar ish-kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale në Hagë, Jack Smith, duket se po e ndjek rrugën e këtij të fundit.

Smith, i cili po hetonte krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Gjykatën Speciale, ishte liruar nga detyra e kryeprokurorit të specializuar, për të marrë një detyrë të re, atë të këshilltarit special nga prokurori i përgjithshëm amerikan, Merrick Garland, për t'i mbikëqyrur hetimet penale ndaj ish-presidentit amerikan

Donald Trump.

E të njëjtën rrugë është duke e ndjekur edhe zëvendësuesi i tij në Gjykatën Speciale, ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit, Whiting.

Siç ka raportuar mediumi prestigjioz amerikan, "Politico", Whitingu tashmë i është bashkuar ekipit të Smithit në gjyqin që pritet të shpalojë në Florida ndaj ish-presidentit Trump. Roli i saktë i Whitingut në ekipin e Smithit ende është i paqartë, ka pohuar "Politico". Për këtë çështje zëdhënësi i Smithit nuk është deklaruar. Ndërsa Whitingu nuk i ka kthyer

përgjigje mediumit amerikan në lidhje me angazhimin e tij në ekipin e Smithit në gjyqin kundër Trump. Whitingu, 58 vjeç, është prokuror me kombësi franko-amerikane me përvojë të gjerë në procedime penale në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Ka punuar në ZPS që nga qershori i vitit 2019, fillimisht si udhëheqës i hetimeve, dhe duke filluar nga muaji gusht 2020 si zëvendësprokuror i specializuar. Whitingu ka ardhur në ZPS nga Fakulteti Juridik i Harvardit, ku ka punuar profesor i praktikës ligjore që nga viti 2013.





TERRORISTËT E ARMATOSUR SËRBE NË VERI SULMOJNË POLICINË E KOSOVËS, NË PËRBALLJE ME TO, VRITET RRESHTERI I POLICISË AFRIM BUNJAKU. SOT (E HËNË) DITË ZIE NË KOSOVË

Rreshteri Afrim Bunjaku bie në mbrojtje të sovranitetit të Kosovës

- Akti kriminal në veri dënohet nga Kosova, Shqipëria dhe bashkësia ndërkombëtare

Rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, është vrarë të dielën në veri të Kosovës gjatë përballjes me forcat e armatosura terroriste serbe. Në ballafaqim me terroristë ka mbetur i plagosur edhe polici Alban Rashiti dhe është lënduar një tjetër. Policia ka njoftuar se tre sulmues kanë mbetur të vrarë në Banjskë të Zveçanit dhe janë arrestuar gjashtë persona të tjerë. Ky akt kriminal është dënuar nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, partitë politike dhe bashkësia ndërkombëtare. Ata i kanë shprehur ngushëllime familjes Bujaku dhe kanë kërkuar të ndalen aktet e tilla kriminale. Në nderim të rreshterit Bujaku sot (e hënë) do të mbahet ditë zie në Kosovë


**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

Prishtinë, 24 shtator - Policia e Kosovës është sulmuar të dielën në mëngjes nga një grup i armatosur serb në veri, konkretisht në fshatin Banjskë të Zveçanit. Nga ky sulm ka mbetur i vdekur rreshteri i policisë Afrim Bunjaku nga Vushtrria. Nga ky sulm është plagosur polici Alban Rashiti

dhe është lënduar një tjetër. Pas sulmit, grupi i armatosur prej 30 personash ka hyrë në manastirin në Banjskë, ku më pas disa janë arrestuar. Ky sulm është dënuar nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, liderët e partive opozitare dhe faktori ndërkombëtar. Fillimisht ka reaguuar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka ndërprerë vizitën në Nju-Jork. Osmani ka thënë se vrasja

në veri është planifikuar, orkestruar dhe ekzekutuar nga bandat kriminale serbe. "Këto sulme dëshmojnë edhe njëherë fuqinë destabilizuese të bandave kriminale të organizuara nga Serbia, të cilat prej shumë kohësh, siç është dëshmuar edhe me sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it, gazetarëve e qytetarëve, po synojnë ta destabilizojnë Kosovën dhe rajonin. Sulmet e



organizuar kundër forcave të rendit të Republikës së Kosovës janë sulme kundër sovranitetit të Republikës së Kosovës. Përveç dënimit të ashpër të këtij agresioni të hapur të Serbisë ndaj Kosovës, pres që aleatët tanë do ta mbështesin Kosovën në përpjekjen e saj për vendosjen e rendit dhe ligjit si dhe ruajtjen e sovranitetit në çdo pjesë të Republikës së Kosovës”, ka thënë Osmani, duke ngushëlluar familjen Bunjaku. “Familjes së policit të vrarë i shprehim ngushëllime të thella dhe e sigurojmë se autorët e këtyre akteve terroriste nuk do të mund t'i ikin drejtësisë.

Ftoj të gjithë qytetarët, institucionet dhe subjektet politike që të qëndrojnë të bashkuar në këtë kohë kur nga Serbia po sfidohen hapur integriteti territorial, siguria dhe sovraniteti i Republikës sonë. Si presidente e Republikës kam besimin e plotë në djemtë dhe vajzat tona nga Policia e Kosovës”, ka thënë Osmani.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se krimi i organizuar me mbështetje politike, financiare dhe logjistike nga Beogradi zyrtar është duke e sulmuar shtetin tonë. “Vrasja e tij (rreshterit policor) duhet të kthehet në angazhim edhe më të shtuar në luftimin e bandave, strukturave ilegale, krimit e terrorizmit, që e cenojnë sigurinë e qytetarëve dhe rendin kushtetues”, ka thënë Kurti në një konferencë për medie pas mbledhjes së Këshillit të Sigurisë.


Ai ka thënë se në këtë sulm kanë qenë të përfshirë paku 30 persona. Teksa ka shfaqur disa fotografi, Kurti ka thënë se banorët lokalë serbë “nuk kanë automjete të tilla dhe asnjë civil tjetër në Republikën e Kosovës”. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka reaguar lidhur me ngjarjen në veri. Ai ka kërkuar nga faktori ndërkombëtar, veçanërisht BE-ja dhe ShBA-ja, ta dënojnë Serbinë për këtë agresion të hapur kundrejt Kosovës. “Ky është një sulm i drejtpërdrejtë ndaj rendit kushtetues, ndaj veprimeve tona për rend dhe ligj

dhe cenim i sovranitetit dhe sigurisë së vendit tonë.

Prandaj, i kërkojmë fuqishëm faktorit ndërkombëtar, veçanërisht BE-së dhe ShBA-së, ta dënojnë Serbinë për këtë agresion të hapur kundrejt Kosovës.

Në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së policit të vrarë, ndërsa policit të plagosur shërim sa më të shpejtë. Autorët e këtij krimi urgjentisht të sillen para drejtësisë, ndërkaj i ftoj institucionet e drejtësisë të veprojnë menjëherë”, është thënë në reagimin e Konjufcës.

Më tutje, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se nga operacioni në veri kanë mbetur të vrarë tre



gjashtë persona. Sipas tij, dy nga të arrestuarit janë “të plagosur, me uniformë dhe të armatosur”, ndërsa katër të tjerë kanë qenë në mbështetje të sulmit me radiolidhje.

Duke folur për gazetarët nga pjesa veriore e vendit, Sveçla ka thënë se aksioni në kërkim të sulmuesve të Policisë së Kosovës është duke vazhduar.

Ai ka thënë se Polica e Kosovës ka zbuluar edhe një sasi të madhe armatimi, përfshirë eksploziv, uniforma, logjistike, ushqime dhe pajisje për barrikada. “Lirisht mund të themi se ishin pajisje për disa qindra sulmues të tjerë. Do të thotë, përgatitjet ishin që një kohë, në mënyrë masive, që ta sulmojnë policinë e Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës dhe seriozisht ta cenojnë integritetin territorial”, është shprehur Sveçla, duke shtuar se ka informacione se bëhet fjalë për një grup terroristësh. “Ne kemi vijë kufitare jashtëzakonisht të gjatë me Serbinë dhe hyrjet e këtyre terroristëve nuk janë të pamundshme, por veprimtaria e tyre tash po bëhet e pamundshme”, ka thënë Sveçla. Në lidhje me rastin në veri ka reaguar edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. “Rreth orës 02:46 të natës së

sotme një grup serbësh nga ‘Kosova dhe Metohia’ vendosi dy kamionë si barrikada në Banjaskë - në veri të Kosovës. Më pas shkoi policia e Kosovës dhe tentoi t'i largojë ato barrikada. Kishte një konflikt me serbët që vendosën barrikada dhe në atë konflikt mbeti i vrarë polici Afrim Bunjaku dhe një person tjetër u plagos”, ka thënë Vuçiqi, duke e fajësuar Kurtin.

Opozita dënon vrasjen e rreshterit të policisë dhe kërkon drejtësi

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, duke dënuar vrasjen e rreshterit Afrim Bunjaku, ka thënë se qëndrojnë të bashkuar në përkrahje të policëve të vendit. “Në këtë moment të dhembjes, qëndrojmë të bashkuar në përkrahje të policëve tanë, të cilët, përkundër sfidave ditore e sulmeve të bandave kriminale të kontrolluara nga Beogradi, po mbrojnë sovranitetin shtetëror në pjesën veriore të shtetit tonë. Ftoj të gjithë që ta dënojnë fuqishëm këtë sulm kriminal kundër Policisë së Kosovës, që është sulm kundër shtetit të Kosovës. Kërkoj nga organet përgjegjëse që hetimet e plota të



bëhen sa më shpejt dhe përgjegjësit të sillen para drejtësisë për t'i marrë dënimet meritore. Në të njëjtën kohë, apeloj tek të gjithë qytetarët për vigjilencë e vetëpërbajtje, sepse përshkallëzimi i situatës në veriun e vendit tonë i konvenon vetëm Serbisë dhe bandave kriminale nën kontrollin e saj. Po ashtu, ftoj partnerët ndërkombëtarë të Kosovës që ta dënojnë qartë sulmin dhe t'i kërkojnë Serbisë urgjentisht ndalimin e ndërhyrjeve në territorin e Kosovës dhe provokimit të mëtejshëm të situatës”, ka thënë Krasniqi.

Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se sulmet e bandave kriminale e terroriste me adresë nga Beogradi s'mund ta zmrapsin Kosovën nga e drejta për vendosje të rendit, ligjshmërisë së sovranitetit. “Institucionet e rendit e drejtësisë t'i sjellin autorët e

Shqipëria dënon vrasjen në veri të Kosovës

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj dhe kryeministri i këtij vendi, Edi Rama, e kanë dënuar ashpër vrasjen e një zyrtari policor në veri të Kosovës. Begaj ka thënë se “ky akt i organizuar kriminal është cenim i rëndë i rendit dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”. “I bëj thirrje komunitetit ndërkombëtar të reagojë me vendosmëri ndaj urdhëruesve dhe zbatuesve të këtij akti tejet të rëndë për stabilitetin e Kosovës dhe paqen në rajonin e Ballkanit Perëndimor”, ka shkruar Begaj në “Facebook”.

Kurse kryeministri Rama ka thënë se “tragjedia e humbjes së jetës së efektivit të Policisë së Kosovës është kambana më e madhe e alarmit deri më sot për rrezikun e vazhdueshëm të eskalimit të krizës së zgjatur në



këtij krimi sa më parë para drejtësisë”, ka thënë Abdixhiku. Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar për vrasjen e rreshterit Bujaku. “Beogradi duhet urgjentisht të heqë dorë nga veprimet e veta destabilizuese e luftënxitëse me pasoja të paparashikueshme jo vetëm për Kosovën, por edhe për Serbinë”, ka thënë Haradinaj. Liderët e shtetit dhe të partive politike të dielën kanë shkruar për ngushëllime në familjen Bunjaku si dhe e kanë vizituar policin e plagosur, Alban Rashiti. Po ashtu, për nder të rreshterit Bunjaku janë nderur qirinjtë në Prishtinë.

një konflikt të armatosur”.

Ai ka thënë se komuniteti ndërkombëtar “duhet ta mbledhë të gjithë forcën e tij imponuese dhe t'i ulë pa kthim Kosovën dhe Serbinë në tryezën e dialogut të normalizimit”.

ShBA-ja dënon ashpër sulmin ndaj Policisë së Kosovës

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, i ka dënuar ashpër sulmet e dhunshme dhe të orkestruara ndaj Policisë së Kosovës, më 24 shtator në veri. “Policia e Kosovës ka legjitimitet të plotë



Foto: AP

për ta garantuar sundimin e ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Ne e pranojmë dhe respektojmë rolin e saj si përgjigja e parë ndaj emergjencave dhe situatave të krizës”, ka thënë ambasadori Hovenier. Duke komentuar vrasjen në veri, ai ka thënë se kryesit e këtyre veprave duhet të mbahen përgjegjës dhe të përballen me drejtësinë.

Hovenieri ka thënë edhe se e vlerëson koordinimin e vazhdueshëm në mes të Policisë së Kosovës, misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR dhe Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX.

Ai u ka shprehur ngushëllime familjarëve të policit të vdekur, ndërsa shërim të shpejtë dy të plagosurve. Vrasja e rreshterit të policisë është dënuar edhe nga Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Turqia etj.

BE-ja dënon sulmin në veri

Kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borell, e ka dënuar ashpër sulmin nga një “bandë e armatosur” kundër zyrtarëve të Policisë së Kosovës në veri. “Të gjitha faktet për sulmin duhet të vërtetohen. Përgjegjësit duhet të përballen

me drejtësinë”, ka thënë Borelli përmes një deklaratë. Në reagimin e BE-së është thënë se më shumë jetë të personave të pafajshëm janë duke u rrezikuar nga armiqësitë rreth Manastirit në Banjskë. “Këto sulme duhet të ndalen menjëherë”, është thënë në reagim.

Në mbrëmjen e së dielës Borelli ka biseduar në telefon me kryeministrin Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. “Përfaqësuesi i lartë, Borelli, përsëriti thirrjen e tij për sulmuesit që të dorëzohen menjëherë, si dhe për lirimin e pelegjërëve në manastirin e Banjskës. Ai bëri thirrje për rivendosjen e qetësisë dhe stabilitetit”, ka njoftuar BE-ja.

Edhe i dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, e ka dënuar sulmin ndaj Policisë së Kosovës në veri dhe ka thënë se dhuna “e çfarëdo forme është e papranueshme”. “Kryesit duhet të përballen me drejtësinë. Të gjithë duhet të kthehen në dialog, menjëherë”, ka thënë Lajçak.


Dhuna në veri dhe vrasja e rreshterit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, është dënuar edhe nga KFOR-i, EULEX-i dhe UNMIK-u. Ngjarja në veri është raportuar edhe në mediet më prestigjioze ndërkombëtare.



Arsenal armësh dhe pajisjeve ushtarake, krejt çka gjeti Policia e Kosovës nga grupi terrorist në Banjskë

Policia e Kosovës, ka bërë publike disa lloje nga arsenalin e armëve që kanë gjetur gjatë kontrollit në disa lokacione e objekte banimi në Banjskë të Zveçanit. Sipas tyre, bëhet fjalë për gjetjen

e dhjetëra, qindra armëve të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm, uniforma dhe pajisje logjistike, përfshirë armë ushtarake të kalibrave të rëndë si granata, zolla, mitralozë, kallashnikov etj.



Haradinaj në Lipjan: AAK-ja po rikthehet fuqishëm

LIPJAN, 24 SHTATOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka takuar drejtuesit e Degës së kësaj partie në Lipjan. Me këtë

rast, Haradinaj ka thënë se AAK-ja po rikthehet në Lipjan më fuqishëm se kurrë më parë. "Qëndrova në Lipjan për një diskutim të lirë me kolegët Aleancës.

Me këtë rast bashkëbiseduam për angazhimet tona të përbashkëta në fuqizimin e Aleancës. Kolegët i falënderova për

angazhimin dhe i urova sukses në punët që na presin. Aleanca po rikthehet në Lipjan më fuqishëm se kurrë!", ka thënë Haradinaj.



Opozita: Nuk do t'i votojmë marrëveshjet ndërkombëtare, pushteti po luan lojë të dëmshme

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Në sesionin vjeshtor të Kuvendit të Kosovës shumica parlamentare do të ballafaqohet me vështirësi për shkak se opozita vazhdon të deklarohet se nuk do të jetë pjesë e votimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare. Opozitarët kanë thënë se ky vendim vjen pas lojës së dëmshme që është duke bërë pushteti.

Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se më nuk mund të jenë pjesë e lojës së dëmshme të pushtetit. "Para sjelljes së kësaj qeverie me faktorin evropian dhe ShBA-në ne nuk mund të jemi pjesë e kësaj loje politike të dëmshme dhe ne do të jemi kundër dhe si reaktion demokratik ne nuk do të bëjmë asnjë lloj kuorumi në instancat parlamentare të vend", ka thënë Shala.



Ndërsa nga AAK-ja kanë thënë se nuk do të jenë pjesë e votimit të

asnjë marrëveshje ndërkombëtare. "Qëndrimi i AAK-së është që ne

nuk do të krijojmë as kuorum dhe nuk do ta mbështesim asnjë

iniciativë. Jemi duke debatuar lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare, a do të kemi ndonjë qëndrim ndryshe, por për momentin as marrëveshjet ndërkombëtare nuk e kemi në plan t'i votojmë", ka thënë deputeti Shemsedin Dreshaj për "RTK"-në. Në anën tjetër, nga partia në pushtet janë shprehur se nga sabotimet e opozitës, më së shumti janë duke pësuar qytetarët. "Edhe angazhimi i tyre është i rëndësishëm sepse e kanë mandatin nga populli dhe qytetarët presin që edhe ata të jenë aktivë dhe të japin përgjegjësi për çka edhe janë emëruar", ka thënë Visar Korenica, deputet i Lëvizjes Vetëvendosje.

Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë sesionit pranveror kishte përbushur vetëm 13 për qind të planit legjislativ.

ETIAS-i nuk do ta nisë funksionimin në vitin 2024?

BRUKSEL, 24 SHTATOR - Bashkimi Evropian (BE) ka shtyrë edhe një herë datën e nisjes së Sistemit Evropian të Informacionit dhe Autorizimit të Udhëtimit (ETIAS). Kështu kanë konfirmuar burime të BE-së për "SchengenVisaInfo.com", e cila shkruan se unioni vazhdimisht ka pretenduar se ETIAS do të bëhej funksional nga mesi i vitit 2024.

Por një zyrtar i BE-së ka konfirmuar se data e nisjes është shtyrë për në maj të 2025-s. Fillimisht ishte shpresuar që edhe EES të bëhej funksional deri në fund të këtij viti ose, më së voni, në fillim të vitit të ardhshëm. Për shkak të vonësave të paparashikuara, është bërë e evidente se ky afat kohor është i paarritshëm.

Si rezultat, zbatimi i ETIAS është riplanifikuar në maj 2025, me mundësi shtyrje të mëtejshme. Si ETIAS ashtu edhe EES janë krijuar nga BE-ja në një përpjekje për ta

rritur sigurinë në bllok dhe për t'i mbajtur gjurmët se kush po planifikon të vijë, kush hyn dhe kush largohet nga territori i BE-së dhe Zonës Shengen. Të dyja ato do të bëjnë një revolucion në udhëtimet drejt dhe nga blloku.

Pritet që ETIAS-i të prekë 1.4 miliard njerëz nga mbi 60 vende të ndryshme të botës, të cilët aktualisht udhëtojnë në 27 vendet e zonës Shengen pa pasur nevojë të marrin një vizë qëndrimi të shkurtër, duke përfshirë këtu amerikanë, britanikë, shqiptarë, kanadezët, etj.

Skema ETIAS fillimisht u vendos të lansohej në vitin 2022 dhe më pas u shty për në fund të të njëjtit vit.

Më vonë, data kur kjo kërkesë u bë e detyrueshme për udhëtarët u zhvendos më 1 maj 2023 dhe pa ndonjë njoftim apo arsye pas një lëvizjeje të tillë, ETIAS u shty për në nëntor 2023.



LDK-ja ia merr AAK-së në Prizren një nga njerëzit kryesor të partisë



PRIZREN, 24 SHTATOR - Ilir Balledaj ka njoftuar se rrugëtimin e tij politik do ta vazhdojë në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Ai duke drejtuar akuza në pushtetin aktual në Prizren, ka thënë se votat e rajonit të Hasit do të jenë garanci që Driton Selmanaj të jetë kryetar i ardhshëm i Prizrenit.

Balledaj ka qenë pjesë e AAK-së dhe kandidat për deputet nga kjo parti në

zgjedhjet e fundit. Ai ka thënë se pa LDK-në nuk mund të zhvillohet Prizreni. "Votat e votuesve për LDK-në në Has dhe kudo në Prizren do të jenë një garanci për kryetarin e ardhshëm të qytetit, i cili do të jetë Driton Selmanaj, kryetari i Degës së LDK-së në Prizren. Pavarësisht përpjekjeve për të më goditur në mënyra të ndryshme që të më eliminojnë politikisht, drejtësia vendore ka

dëshmuar se jam i pastër sikur loti. Dhe, si i tillë nga sot i bashkohem LDK-së për t'i mposhtur politikisht të gjithë ata që i kanë bërë dëm Prizrenit, për ta rikthyer LDK-në në qeverisjen e qytetit. 'Rruga e re' është një garanci e rikthimit të fuqishëm të LDK-së në pushtetin lokal në Prizren. Me rikthimin e LDK-së, do ti kthehet shpresa dhe jeta e vërtetë Prizrenit!", ka thënë Balledaj.

Greçia është 'aktorja kryesore' e destruksionit në rajonin tonë



Shkruan: **Milazim KRASNIQI**

Deklarata e ministres Donika Gërvalla për Greçinë, si "një aktor kryesor në rajonin tonë me të cilin ne ndajmë një gamë të gjerë vlerash dhe qëllimesh" nuk shprehë të vërtetën. Në të vërtetë, Greçia tërë këto decenie,

që nga fillimi i krizës së ish Jugosllavisë, ka qenë aktor i destabilizimit të rajonit dhe përkrahëse e politikave serbe të agresionit.

1. Greçia e ka përkrahë hapas Millosheviqin në projektin e tij për Serbinë e Madhe. Ka qenë proklamuar edhe një federatë serbo-greke, (Për ta qëllitë Maqedoninë) të cilën Millosheviq e pati quajtur si "oksigjen për ortodoksinë".

2. Greçia pati përkrahë politikën gjenocidale të Karaxhiqit në Bosnje.

3. Greçia ka bllokuar me decenie Maqedoninë, deri sa ia imponoi edhe ndryshimin e emrit.

4. Greçia nuk e pranon shtetin e

Kosovës dhe faktikisht e nxitë destabilizimin rajonal, duke e përkrahë politikën imperiale serbe.

5. Greçia e mban ende ligjin e luftës ndaj Shqipërisë, për pushtimin italian të Greçisë. Dhe bën lloj lloj presionesh destabilizuese mbi Shqipërinë, si sponzorizimi i rebelimit të vitit 1997, aksioni "Fshesa" e deri te presionet e tashme për rastin Beleri.

6. Përtej politikave të saj destruktive e destabilizuese në rajon, Greçia ka qenë "aktor kryesor" në kërcënimin e paqes në Mesdhe. Politikat greke të anshlusit të Qipros dhe rreziku që ajo politikë të hapë mundësitë

e penetrimit të BRSS në limanet greke e qipriote, pati provokuar intervenimin turk në Qipro, të lejuar edhe nga ShBA.

7. Që nga viti 1981, kur Greçia u bë anëtare e Bashkimit Evropian, ajo edhe në Bashkimin Evropian më shumë ka prodhuar kriza, se sa vlera. Kriza e saj financiare shkaktoi turbulenca të mëdha në BE, duke rrezikuar edhe ekzistencën e euros. 8. Greçia ka modelin partiak më të keq të mundshëm: partitë kryesore politike janë si biznese familjare të disa familjeve si familjet Papandreu, Micotakis, të cilat qeverisin me decenie, duke u alternuar. Prandaj duket jonormale kjo lloj grekofilie e

qeverisë Kurti, jo vetëm në rastin e ministres Gërvalla. Nuk besoj se mund t'i aftribohet virulenca e kësaj grekofilie vetëm ndikimit të një nëpunëseje të LV-së, si Dejana Mihali. As preferencave ideologjike të majta të Kurtit, ngase Micotakis është i qendrës së djathtë. As mungesës së informatave për rolin destruktiv të Greçisë në krizën në ish-Jugosllavi. As mungesës së përvojës për qëndrimin zyrtar grek kundër pavarësisë së Kosovës. Nuk ka as mungesë njohurish për politikën konstante antishqiptare të qeverive greke. Duhet të ketë diçka më shumë dhe përtej asaj që dihet e që duket.

Integrim para anëtarësimit të vendeve kandidate në BE



BRUKSEL, 24 SHTATOR - Idetë që vendet evropiane, të cilat synojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE), gradualisht të integrohen në disa politika të BE-së, por edhe në punën e institucioneve, janë shpeshuar. Ka pasur shumë thirrje, përfshirë edhe nga liderët e vendeve anëtare dhe të institucioneve të Bashkimit Evropian, që një lloj "integrimi para anëtarësimit" të përdoret për t'i përafuar vendet kandidate me BE-në, edhe para se ato të bëhen formalisht vende anëtare.

Të gjitha vendet kandidate, si ato nga rajoni i Ballkanit Perëndimor ashtu edhe nga fqinjësia lindore (Ukraina, Moldavia dhe Gjeorgjia), kanë marrëveshje të Asocimit me BE-në dhe bashkëpunim në disa fusha. Por në BE besojnë se ekziston mundësia që, pa ndryshuar traktatet, ky bashkëpunim të forcohet, duke përfshirë këto shtete në takime të përbashkëta, grupe punuese, projekte të ndryshme të infrastrukturës, prokurime të përbashkëta deri te bashkëpunimi në politika sociale dhe ekonomike. Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (EESC European

Economic and Social Committee) tashmë ka vendosur që në strukturat e veta t'i përfshijë edhe përfaqësuesit nga vendet e procesit të zgjerimit. Në këtë mënyrë ky institucion i BE-së, që ka rol profesional këshillues për çështjet politike dhe sociale, bëhet institucioni i parë i Bashkimit Evropian i cili përfshin përfaqësuesit nga vendet kandidate në strukturat e veta punuese. "Ne po e shndërrojmë një prioritet politik në realitet, duke u bërë institucioni i parë i BE-së që përfshin vendet kandidate për BE në punën e vet", është thënë në një komunikatë të Komitetit Social dhe Ekonomik, ku është njoftuar se është miratuar vendimi që të emërohen përfaqësuesit e shoqërisë civile nga vendet kandidate në punën këshilluese të Komitetit.

Ata do të quhen "anëtarë kandidate të zgjerimit" dhe do të marrin pjesë në përgatitjet e opinionëve dhe qëndrimeve të këtij komiteti si dhe në seancat plenare, të cilat në fokus do ta kenë procesin e zgjerimit. Presidenti i këtij komiteti, Oliver Ropke, ka thënë se kjo nisimë ka hasur në reagime pozitive edhe nga

Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian, Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të BE-së dhe institucione të tjera relevante të BE-së.

"Vendet kandidate kanë nevojë për më shumë sesa vetëm fjalë të thata. Ato kanë nevojë për veprime konkrete. Sot EESC merr vendim konkret, duke u dëshmuar atyre se ne jemi partner i besueshëm, i cili mund t'i përmbushë premtimet. Është vërtet një moment historik", ka thënë Ropke duke shprehur bindjen se që nga fillimi i vitit 2024 anëtarët nga vendet e zgjerimit do ta nisin punën me kolegët e tyre në këtë komitet.

Pjesëtarët nga vendet e zgjerimit, që do të marrin pjesë në punën e Komitetit Ekonomik dhe Social të BE-së, do të selektohen deri në fund të këtij viti dhe ata do të jenë nga organizatat e shoqërisë civile. Nga ky komitet është thënë se gjatë selektimit do të merren parasysh përvoja dhe pavarësia e tyre dhe do të sigurohet respektimi i barazisë gjinore. Po ashtu, do të kërkohet që të ketë sa më shumë përfaqësues edhe nga organizatat e të rinjve. Një prej punëve të para, ku planifikohet të përfshihen

përfaqësuesit nga vendet e zgjerimit, do të jetë përgatitja e opinionit të EESC-së për gjendjen e demokracisë dhe rolin të shoqërisë civile në këtë vende, dialogun social dhe prioritetet me të cilat përballesh vendet kandidate në fushat e rëndësishme për avancim drejt BE-së.

Sipas një kalendari që ka përgatitur EESC, deri në dhjetor do të përmbyllet procesi i selektimit të përfaqësuesve nga vendet e zgjerimit, në janar do të zhvillohet takimi inaugurues, në mars ose prill do të themelohen grupet e para punuese, ndërsa në qershor të vitit të ardhshëm do të zhvillohet seanca plenare e EESC-së me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga vendet e zgjerimit.

Ky komitet, një lloj sikurse Komiteti i Rajoneve, është institucion i BE-së që ka rol këshillues. Në këtë komitet marrin pjesë përfaqësuesit e shoqërisë civile, sindikatave, organizatave të biznesit, odave ekomomike, akademikë dhe të tjerë nga të gjitha vendet anëtare. Opinione të tyre pastaj merren parasysh nga institucionet vendimmarrëse të BE-së, si

Komisioni Evropian, Parlamenti dhe Këshilli.

Institucionet e tjera të BE-së, po ashtu, kanë bashkëpunim të ngushtë me vendet e procesit të zgjerimit. Por ky bashkëpunim është më shumë politik dhe këshillues sesa formal.

Këshilli i BE-së shpesh mbledh, në nivele ministrore, përfaqësuesit e vendeve anëtare dhe vendeve kandidate në takime që kanë tema të interesit të përbashkët si politika e jashtme dhe siguria, punët e brendshme me fokus në çështjet e migracionit, lufta kundër krimit të organizuar, kundër radikalizmit dhe trafikimeve. Po ashtu, ka takime të përbashkëta për infrastrukturën rrugore e hekurudhore, për energji dhe disa fusha të tjera. Parlamenti Evropian ka takime të përbashkëta me komisionet parlamentare të vendeve kandidate. Në të ardhmen edhe institucionet e tjera të BE-së planifikojnë të përfshijnë më shumë, edhe formalisht, partnerët e vendeve të zgjerimit në punën e tyre, siç ka bërë Komiteti Ekonomik dhe Social që thotë se e ka hapur këtë rrugë të pari.

Tahiri: Ekonomia e Kosovës është buzë kolapsit, qeveria të veprojë

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka kritikuar qeverinë Kurti duke thënë se vendi po kalon nëpër një krizë që, sipas tij, është një ndër më të thellat si në rrafshin politik të brendshëm dhe në atë të jashtëm, po ashtu në aspektin ekonomik.

Ai ka thënë se ekonomia e Kosovës është buzë kolapsit dhe sektori privat është duke u ballafaquar me vështirësitë më të mëdha që i ka pasur në dhjetë vitet e fundit. "Problemet e shkaktuara nga qeveria me mosinvestime kapitale, tash e tri vjet, pra me mosshfrytëzimin e më shumë se 1 miliard euro për t'i futur

në qarkullim, politikat ekstremisht të gabuara fiskale, tatimore dhe mosthithja e investimeve të huaja, është kah e rrezikon secilin investim në sektorin privat", ka shkruar Tahiri në "Facebook". Më tutje, Tahiri është shprehur se sektori privat në Kosovë është duke hyrë në një periudhë kohore shumë të

padefinuar, është në mjegull dhe në rrezik të ekzistencës së tyre. "Është tejet e rëndësishme që qeveria të ullet e të bisedojë me sektorin privat se si të dilet nga kjo krizë, e cila e ka prekur secilin aktivitet të biznesit të vogël, të mesëm dhe të korporatave", ka shkruar Tahiri, duke shtuar se para se të bëhet vonë e të



ketë kolaps të sistemit të ekonomisë në vend, qeveria duhet të veprojë.

Eksporti shënon rënie mbi 20 për qind, e mbulon importin me vetëm 12.9 për qind

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Deficiti tregtar është rritur për 3.1 për qind në gusht të këtij viti krahasuar me gushtin e vitit të kaluar, ndërsa që eksporti ka rënë për 20.7 për qind. Sipas të dhënave që i ka publikuar Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), eksporti i mallrave në muajin gusht 2023 kishte vlerën 67.3 milionë euro, ndërsa importi 523.1 milionë euro. Sipas ASK-së, kjo paraqet një rënie

prej 20.7-përqindësh eksport si dhe 0.7 për qind për import, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

"Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 3.1 për qind në muajin gusht 2023 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022, gjegjësisht në vlerë prej 455.8 milionë eurosh krahasuar me deficitin 441.9



milionë euro në vitin 2022. Eksporti mbulon importin me 12.9 për qind", është thënë në njoftimin e ASK-së. Më tutje, sipas të dhënave të

grupeve kryesore të eksportit, 21.7 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar, 19,1 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre, 13.7 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 12.3 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre dhe 5.4 për qind e përbëjnë produktet bimore.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import,

16.9 për qind e përbëjnë produktet minerale, 12.6 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 10.8 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, 10.3 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre, 9.4 për qind e përbëjnë mjetet e transportit, 6 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike dhe 5.9 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij.

Kurti thotë se për dy vjet e gjysmë pati rritje ekonomike të buxhetit dhe eksportit

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se gjatë dy vjet e gjysmë qeverisje, rritja ekonomike mesatare ka qenë 7.9 për qind që, sipas tij, ka qenë më e larta se çdoherë për dy vjet rresht që nga viti 2008. Ai ka thënë se përgjatë kësaj kohe është rritur edhe vlera e eksporteve, ndërsa në vitin 2023 pritet të ketë rritje deri në 1 miliard euro. "Vitin e parë të qeverisjes rritja ekonomike ishte 10.7 për qind, më e larta në historinë e vendit. Në vitin e dytë rritja ekonomike ishte 5.2 për qind (2022). Rritja mesatare në dy vite ka qenë 7.9 për qind, më e larta se çdo herë tjetër për dy vite rresht që nga shpallja e Pavarësisë. Trendi i rritjes ekonomike ka vazhduar edhe këtë vit. Vlera e eksporteve në vitin 2022 është rritur për 447 milionë euro ose dyfishuar në krahasim me vitin 2020. Për

periudhën janar-korrik të këtij viti vlera e eksporteve ka qenë 468 milionë euro, që është përafërsisht aq sa ka qenë totali i vlerës së eksporteve në vitin 2020 (474 milionë euro). Deri në fund të 2023 pritet që vlera e eksporteve për herë të parë të arrijë shifrën 1 miliard euro. Si rezultat, raporti eksport-import është ngushtuar nga gati 1 me 9 sa ishte në vitin 2019, në më pak se 1 me 6 sa është aktualisht. Ndërkohë që për herë të parë, në tremujorin e dytë të këtij viti ekonomia e vendit tonë ka tejkaluar shifrën prej mbi 400 mijë vendeve aktive të punës", ka shkruar Kurti në "Facebook". Kryeministri Kurti ka thënë se ka pasur rritje edhe të buxhetit të vendit, duke shtuar mbi 770 milionë euro të hyra. "Gjatë qeverisjes së deritanishme, buxhetit të shtetit ia kemi shtuar mbi 770 milionë euro të hyra, kurse ekonomisë 2.1



miliardë euro vlerë. Të hyrat tatimore janë rritur për rreth 2/3, ndërkohë që Investimet e Huaja Direkte janë dyfishuar. Trendi i rritjes së Investimeve të Huaja Direkte ka vazhduar edhe sivjet. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, për periudhën janar-maj 2023 kemi 20.7 për qind më shumë investime se në periudhën e

njëjtë të vitit të kaluar", ka shkruar Kurti.

Ai ka thënë se të gjitha këto i kanë ndarë me qytetarët duke shpërndarë 842 milionë euro përmes masave të ndryshme. "Rritjen e ndamë me qytetarët duke rishpërndarë në total 842 milionë euro përmes masave të ndryshme mbështetëse për qytetarë dhe stimuluere për

biznese, dhe pa krijuar borxhe të reja. Deficitin buxhetor në vitin 2022 e kemi ulur në nivel historik duke e zvogëluar atë për mbi -90% në krahasim me vitin 2020. Kurse inflacioni në muajin korrik ishte më i ulëti në gjithë Gadishullin Ballkanik, me vetëm 2.4 për qind", ka shkruar Kurti.

Këto statistika të paraqitura nga Kurti janë kontestuar nga opozita, duke pretenduar se kryeministri është duke mashtruar. "Kryeministri po thotë se ekonomia e Kosovës qenka duke ecë mirë, sepse është më mirë sesa në vitin 2020, vit ky kur ekonomia ishte e mbyllur për shkak të pandemisë. Kjo nuk do shumë koment! Kjo qeveri nuk ka me çka të krenohet! Kjo qeveri ka propagandë dhe vetëm propagandë!", ka thënë koordinatori i PDK-së për ekonomi, Arben Mustafa.

KOSTT-i ia kërkon Kuvendit mbi 23 milionë euro për rrymën në veri

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) nëpërmjet një letre dërguar kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, ka alarmuar për humbjet në veri të Kosovës. Sipas kësaj letre të cilën e ka siguruar gazeta "Epoka e re", mbi 23.6 milionë euro është kostoja e pambulluar e furnizimit me energji elektrike në katër komunat në

veri të Kosovës. "Energjia elektrike e konsumuar në katër komunat në pjesën veriore të Kosovës ka vazhduar të tërhiqet nga rrjeti i Evropës kontinentale, duke i pamundësuar KOSTT-it kryerjen e detyrimit për balancimin e sistemit sipas Marrëveshjes se Kyçjes KOSTT-ENTSO-E dhe ligjeve në fuqi. Aktualisht KOSTT në përputhje me Marrëveshjen e Kyçjes me RGCE\ENTSO-E

është duke operuar si zone rregulluese e pavarur. KOSTT-i në të ardhmen aspirojnë anëtarësimin e plotë në ENTSO-E, e cila në vazhdimësi monitoron përmbushjen e kushteve teknike, obligimeve dhe detyrime kontraktuale nga KOSTT-i. Deri më tani, kosto e pambulluar e furnizimit të pjesës veriore të Kosovës përmes devijimeve për periudhën dhjetor 2022 - korrik 2023 ka arritur në

vlerën 23.628.921.00 milionë euro, pa përfshirë përlogaritjen e interesave nga JAO", është thënë në letren e KOSTT-it.

Nëpërmjet kësaj letre KOSTT-i ka kërkuar ndihmën e shtetit për t'i mbuluar këto humbje. Sipas kësaj letre, për shkak të mospërmbushjes së obligimeve, KOSTT-i rrezikon të dënohet me 5 milionë euro dhe të përjashtohet nga Marrëveshja e Kyçjes.



Qasja e Perëndimit ndaj Vuçiçit rrezikon të destabilizojë rajonin



Nga Christian EDWARDS

Kur Rusia pushtoi Ukrainën, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian përshpejtuan kthesën e tyre drejt Serbisë. Në vend që të merreshin me kërkesat kontradiktore të shteteve përbërëse të një Ballkani të fragmentuar, kryeqytetet perëndimore përqendruan pjesën më të madhe të përpjekjeve të tyre, në një objektiv të veçantë.

Politikat e tyre kishin dy synime. Së pari, ta fusnin Serbinë në vathën perëndimore, larg Ruisë. Së dyti, të lejonin administratat e tyre përkatëse që të fokusoheshin plotësisht në mbështetjen e Ukrainës. Tradicionalisht një nga aleatët

më të afërt të Moskës në Evropë, Beogradi është përpjekur prej kohësh të shkelë kufirin midis lidhjeve të tij historike me Rusinë dhe një të ardhmeje të mundshme të një integrimi më të ngushtë evropian. Diplomatat perëndimore kanë kërkuar ta tërheqin presidentin serb Aleksandar Vuçiç nga orbita e homologut të tij rus, presidentit Vladimir Putin, duke u zotuar për një rrugë më të shpejtë drejt anëtarësimit në BE, si dhe duke paralajmëruar me izolim.

Por, 18 muaj më vonë, disa vëzhgues thonë se qasja aktuale ka qenë e gjitha “karrotë” pa shkop, dhe si rezultat nuk po i arrin synimet e saj. Serbia ka refuzuar të marrë pjesë në të gjitha raundet e sanksioneve të BE-së kundër Putinit. Dhe Serbia ka

vazhduar të ndjekë interesat e veta në rajon me një përgjegjshmëri në rënie, duke nxitur konflikte jashtë vendit për të larguar vëmendjen nga pakënaqësitë e brendshme, e sigurtë se nuk do të qortohet në Perëndim.

Efektet e kësaj sjelljeje janë ndjerë më së shumti në Kosovë, e cila arriti pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, pas luftërave të përgjakshme ballkanike të viteve 1990. Por Beogradi – dhe shumë serbë etnikë në veri të Kosovës – ende refuzojnë të njohin sovranitetin e saj, duke tensionuar marrëdhëniet mes fqinjëve.

“Një kalë troje i Ruisë”

Qeveritë perëndimore e kanë trajtuar prej kohësh Serbinë si zërin e domosdoshëm ballkanik, ndonjëherë në

kurriz të lojtarëve më periferikë, thonë disa vëzhgues.

“Besimi i tyre është se Serbia është shteti ballkanik, siç e shohin ata. Serbia është ajo që, nëse mund t’a afrosh e ta kesh në krah – cilido qoftë kuptimi i kësaj – gjithçka do të jetë më e lehtë”, tha për CNN Jasmin Mujanoviç, një politolog i specializuar në Ballkanin Perëndimor.

Ndërsa administratat e njëpasnjëshme amerikane janë përpjekur të nxjerrin Vuçiçin dhe Partinë e tij Progresive Serbe (SNS) “nga i ftohti”, këto përpjekje “janë bërë veçanërisht të pacipa” që nga fillimi i luftës në Ukrainë, tha Mujanoviç dhe nuk i kanë arritur objektivat e SHBA.

“Ata duket se besojnë që po e afrojnë Serbinë drejt BE-së dhe NATO-s dhe drejt mendimit perëndimor dhe larg Ruisë.

Por kjo nuk është diçka që po reflektohet në terren,” thotë Alicia Kearns, deputete britanike dhe kryetarja e Komisionit të Përzgjedhur të Punëve të Jashtme parlamentare.

Vuçiç ka mbajtur prej kohësh një marrëdhënie komode me homologun e tij rus, Putinin. Duke folur pas një takimi të Këshillit të Sigurisë Kombëtare në shkurt, Vuçiç arsyetoi vendimin e tij për të mos sanksionuar Rusinë, sepse ishte “i vetmi vend që nuk kishte vendosur sanksione kundër nesh në vitet 1990”.

“Ata mbështetën integritetin tonë territorial në Kombet e Bashkuara”, shtoi ai, duke iu referuar refuzimit të Ruisë për të njohur pavarësinë e Kosovës.

Serbia humbi kontrollin e Kosovës pas një fushate bombardimi të NATO-s në

vitin 1999, e cila i dha fund masakrës së shqiptarëve etnikë – të cilët përbëjnë më shumë se 90% të popullsisë së Kosovës – nga forcat serbe.

Pavarësisht përpjekjeve të mbështetura nga BE drejt tranzicionit energjetik, Serbia mbetet shumë e varur nga Rusia, pasi i ka shitur shumicën e aksioneve të kompanisë së saj të naftës gjigantit shtetëror rus Gazprom.

Rezultati është se, pavarësisht nga shpresat e shpallura të Serbisë për t'u bashkuar me BE-në, Vuçiç ka vazhduar të ecë në një litër të hollë, midis Moskës dhe fuqive perëndimore. Megjithëse ai i është bashkuar rezolutës së OKB-së që dënon pushtimin e Rusisë në Ukrainë, udhëheqësi i Serbisë ka treguar pak vullnet për t'iu bashkuar sanksioneve perëndimore.

Në prill, qeveria serbe mohoi raportet se i shiste armë dhe municione Ukrainës, pasi doli një dokument i Pentagonit që pretendonte të kundërtën. Serbia tha në atë kohë se ruante politikën e saj të neutralitetit, megjithëse disa zyrtarë perëndimorë i morën raportet si provë se politika e tyre po funksiononte.

Disa analistë i thanë CNN se Serbisë i është dashur të bëjë shumë pak për të marrë lëvdata nga zyrtarët amerikanë dhe evropianë dhe se në realitet Vuçiç ka lënë një pas një gjurmë të gjatë premtimesh të shkelura.

“Kur ndodhi rizgjedhja e tij [Vuçiçit në vitin 2020], të

gjithëve na thanë, vetëm prisni deri pas zgjedhjeve, do të shihni se ai papritur do bëhet shumë i orientuar nga perëndimi dhe Europa”, thotë Kearns. “Nuk ndodhi.”

“Na u tha se ai do t'i bashkohej sanksioneve dhe do të tregonte se është vërtet në anën tonë. Nuk ndodhi. Na thanë se ai nuk do të afrohej më shumë me Rusinë. Ai firmosi një marrëveshje sigurie me Putinin në shtator. Herë pas here, ai qesh përballë Perëndimit. Dhe kur i pyes zyrtarët perëndimorë, ‘pse jeni kaq të vendosur të lejoni Vuçiçin të luajë me ju?’, ata thonë se ai është alternativa më e mirë,” thotë Kearns.

Ministri i Jashtëm i Serbisë tha në atë kohë se marrëveshja me Rusinë parashtronte plane për konsultime për një numër aktivitete, por nuk përfshinte politikën e sigurisë, raportoi Reuters.

Kearns ka qenë një nga figurat e pakta perëndimore që ka kritikuar Serbinë publikisht. Por kjo ka ardhur me një kosto. Pasi foli për CNN, Vuçiç lëshoi një kërcënim të hapur ndaj saj gjatë një fjalimi në televizionin shtetëror, duke pretenduar se “nëse qeveria e Britanisë së Madhe nuk është e gatshme të reagojë” ndaj kritikave të saj ndaj Serbisë, “ne do të detyrohemi të reagojmë”.

Duke pasur parasysh një sjellje të tillë, shumëkush pyet nëse i gjithë projekti i integritetit serb është i zbatueshëm, nën qeverinë e saj aktuale.

“Duke supozuar se do ia dalim ta sjellim, falë ndonjë

mrekullie Serbinë në BE, me këtë lloj regjimi, ju praktikisht po fusni një kalë tjetër troje të Rusisë në BE, siç e kemi sot në formën e kryeministrit hungarez Viktor Orban,” thotë për CNN Majda Ruge, një eksperte për Ballkanin në Këshillin Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë.

“Po, mund të ndikoni për zgjerimin por me siguri që nuk do ta neutralizoni ndikimin rus në rajon – thjesht do ta importoni atë në BE”.

Në një deklaratë për CNN, ambasadori i Serbisë në Shtetet e Bashkuara mohoi se mbështetja perëndimore për Beogradin po nxiste tensionet në Ballkan. “Në të vërtetë, mbështetja e SHBA-së dhe e Europës për Serbinë bazohet në faktin se këta diplomatë pranojnë që Serbia po luan sot një rol të rëndësishëm në promovimin e stabilitetit në Ballkan”, tha Marko Duric.

“Serbia është thellësisht e përkushtuar për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian dhe ka votuar për rezolutën e Kombeve të Bashkuara që dënon veprimet ruse në Ukrainë dhe ka mbështetur integritetin territorial dhe sovranitetin e saj, si dhe ka dërguar në mënyrë të përsëritur lloje të ndryshme ndihme.”

Kosova dhe sundimi i ligjit

Efektet e qasjes së zbutur të Perëndimit ndaj Beogradit ndihen më fort në Kosovë, e cila ka qenë e varur nga

mbështetja perëndimore që nga shpallja e pavarësisë. Ndërsa më shumë se 100 vende e njohin sovranitetin e saj, Serbia nuk e njeh, duke e parë atë si një shtet të shkëputur. Përpjekjet për të normalizuar marrëdhëniet midis dy vendeve – të mbikëqyrura nga SHBA dhe BE – kanë qenë të tensionuara dhe herë pas here të dhunshme.

Tensioni u shtua sidomos pas zgjedhjeve për kryetar komunash në katër komunat veriore të Kosovës në maj. Këto zgjedhje shpesh kalojnë pa bujë: Rreth 90% e popullsisë në këtë rajon janë serbë etnikë, dhe kështu, në rrethana të zakonshme, ata zgjedhin serbët etnikë për kryetarë komunash.

Por këto nuk ishin rrethana të zakonshme. Në nëntor, kryebashkiakët nga partia Lista Serbe e mbështetur nga Beogradi, e cila dominon katër komunat, dhanë dorëheqjen njëkohësisht. Ata u pasuan nga oficerë policie, personel administrativ dhe gjykatës serbë etnikë në rajon.

Dorëheqjet e tyre shkaktuan zgjedhje të reja, që do të mbaheshin në dhjetor. Lista Serbe tha se nuk do të marrë pjesë në zgjedhje, pasi serbët në rajon i bojkotuan ato, me mbështetjen e plotë të Vuçiçit. Por, duke pasur parasysh tensionet, Kosova pranoi të shtyjë zgjedhjet deri në prill – një vendim që u vlerësua nga Pesëshja, një grup joformal që përfshin SHBA-në, Britaninë e Madhe, Francën, Gjermaninë

dhe Italinë.

Me mospjesëmarrjen e serbëve të Kosovës, kandidatët shqiptarë etnikë garuan pa rivalë. Zyrtarët zgjedhorë thanë se vetëm rreth 1,500 njerëz votuan në të katër komunat – një pjesëmarrje prej vetëm 3.5%. Disa kryetarë bashkie u zgjodhën me më pak se 100 vota.

Por ndërsa zgjedhjet nuk ishin aspak përfaqësuese, për kryeministrin e Kosovës Albin Kurti, çështja tashmë kishte të bënte me vetë sundimin e ligjit.

“Kemi katër kryetarë komunash, legjitimiteti i të cilëve është i ulët. Por, megjithatë, nuk ka njeri që është më legjitim se ata. Duhet të kemi shtet ligjor. Ne jemi një republikë demokratike”, tha Kurti për CNN në maj.

Megjithatë, qëndrimi i kryeministrit është kritikuar si i ashpër dhe i pakompromis. Aleatët e tij e akuzuan për hyrjen me forcë në zyrat e kryetarëve të komunave më 26 maj.

“Shtetet e Bashkuara i thanë Kurtit – dhe këtu ai është në faj – ata i thanë të mos i vendoste kryetarët në ndërtesat e komunave. Dhe këtu Kurti e injoroi udhëzimin specifik”, tha Edward Joseph, një pedagog i politikës së jashtme në Universitetin Johns Hopkins, i cili ka shërbyer për shumë vite në Ballkan, duke përfshirë NATO-n.

Një zyrtar i qeverisë së Prishtinës i tha CNN se ata nuk donin t'ua “dorëzonin” ndërtesat zyrtare qeveritare



protestuesve. “Kryetarët e komunave hynë në zyrat e tyre... Serbia u kishte kërkuar serbëve që të bojkotonin zgjedhjet. Tani donin që askush të mos hynte në ato ndërtesa. Por atëherë, pyetja është: Nëse kryetarët e bashkive nuk duhet të hyjnë në ndërtesë, kush duhet të hyjë?”

Por ndërsa Kurti mund të ketë ndërmarrë një veprim të pakoordinuar, përgjigja ndaj kësaj nuk ishte e pashmangshme. Më e keqja e dhunës nuk erdhi në ditën kur kryetarët e komunave hynë në zyrat e tyre, por tri ditë më vonë, në qytetin e Zveçanit – kur kryetari as nuk ishte në ndërtesë.

Dhuna ishte ekstreme. Dhjetëra paqeruajtës të NATO-s u plagosën pasi u sulmuan nga serbët etnikë. Disa plagosje ishin të rënda: Tre ushtarë hungarezë u qëlluan; njërit i është prerë këmba.

Kurti tha për CNN se këta nuk ishin “protestues paqësorë”, por një “milici fashiste” e njohur se vepron në veri të Kosovës, “të cilët paguhen dhe urdhërohen nga Beogradi”.

Të tjerët pajtohen me Kurtin. Kearns i tha CNN se trupat britanike të stacionuara në Kosovë si pjesë e KFOR-it, Forca e NATO-s në Kosovë, “dëgjuan për granata tek pragu i dyerve të njerëzve nëse ata refuzonin të mbështesnin milicinë serbe”. Kearns tha se trupat britanike gjithashtu i thanë që kishin gjetur “depo armësh të fshehura në kisha dhe ambulanca nga milicia serbe në veri të Kosovës”, megjithëse KFOR-i tha në korrik se nuk kishte gjetur asnjë provë për këtë pretendim.

Pavarësisht kësaj, pjesa më e madhe e reagimeve diplomatike është fokusuar në veprimet e Kurtit, për të cilat Kosova ka paguar një çmim të rëndë. Që pas zgjedhjeve, Kosova nuk është ftuar në stërvitjet e përbashkëta ushtarake me SHBA-në, është përjashtuar nga projektet evropiane të infrastrukturës dhe është goditur me sanksione që Aleanca Kosovare e Biznesit thotë se mund t'i kushtojnë ekonomisë së saj 500 milionë euro (550 milionë dollarë), deri në fund të këtij viti.

Kearns kritikoi përgjigjen “e pabalancuar” nga Perëndimi, duke thënë se ajo injoronte shkakun e vërtetë të telasheve. “Fillimi i krizës ishte ndërhyrja e jashtme e qeverisë serbe në punët e brendshme të Kosovës, kur u tha serbëve të Kosovës që të mos votojnë në zgjedhjet lokale. Kjo është ndërhyrje nga jashtë”, tha ajo. Kurti është përpjekur të

shpallë sovranitetin e Kosovës kundër forcave binjake të ndërhyrjes së huaj dhe dhunës së organizuar, dhe sipas Mujanoviçit, SHBA-ja dhe BE-ja janë përgjigjur: “Jo. Kjo nuk është e përshtatshme në këto rrethana.”

“Zelensky i Ballkanit”

Duke pasur parasysh varësinë e Kosovës nga mbështetja perëndimore, disa kanë frikë se mospajtueshmëria e Kurtit po i frustron aleatët e tij dhe po dobëson vendin. Disa po bëjnë thirrje për një ndryshim të plotë të qëndrimit.

“Ai po përpiqet të jetë Zelensky i Ballkanit”, tha për CNN Shqiprim Arifi, kryetar i rajonit jugor serb të Preshevës. “Ai po përdor në mënyrë retorike dhe në mënyrë populiste argumentimin e shtetit të së drejtës. Ai dëshiron të jetë Zelensky i shqiptarëve.”

Lugina e Preshevës në Serbi përfaqëson anën tjetër të veriut të Kosovës. Ndërsa veriu i Kosovës është i populluar kryesisht me serbë etnikë në një vend me shumicë shqiptare, Lugina e Preshevës është e populluar kryesisht me shqiptarë etnikë në një vend me shumicë serbe.

Mënyra më e mirë për të përmirësuar situatën, tha Arifi, është që Kurti të bëjë ashtu siç kërkojnë aleatët perëndimorë: Të punohet për të krijuar “Asociacion të Komunave Serbe” (ASM) në veri të Kosovës.

Kurti është akuzuar se ka penguar zbatimin e krijimit të komunave vetëqeverisëse për serbët, siç parashikohet në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 që synon normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet fqinjëve ballkanikë. Sipas marrëveshjes, Serbia mund të krijojë ASM-në në veri të Kosovës, e cila do të funksiononte nën sistemin ligjor të Kosovës, me policinë kosovare që mbetet autoriteti i vetëm i zbatimit të ligjit.

Një dekadë më vonë, këto komuna nuk janë krijuar, duke i lënë të ziejnë mosmarrëveshjet për shkallën e autonomisë së serbëve të Kosovës.

Por ka dyshime nëse kjo zgjidhje – që tani po shtyhet me forcë nga SHBA dhe BE – do të lehtësojë tensionet.

“Më besoni, nuk do të jetë zgjidhja më e mirë,” i tha CNN Dushan, një serb që jeton në komunën e Leposaviqit. “Ndoshta, në dy muajt e parë do të jetë një lehtësim. Ndoshta do mendohet ‘Oh shiko, më në fund morëm diçka.’”

Por do të ishte një agim i rremë. “Nga aspekti ekonomik,



jeta jonë nuk do të përmirësohet, por do të jetë më keq”, tha ai, pasi banorët do të duhet të fillojnë të paguajnë për shërbimet dhe taksat që aktualisht mbulon qeveria e Kosovës. CNN po fsheh emrin e vërtetë të Dushanit, pasi ai kishte frikë se komentet e tij mund të ndikonin në jetesën e tij. Ekzistojnë gjithashtu shqetësime se ASM mund të nxisë më shumë tensione gjeopolitike.

“Ne nuk e dimë se cilat do të jenë këto komuna,” tha Kearns. “A do të jetë thjesht që komunat lokale të jenë përgjegjëse për ujën, rrymën dhe taksat e tyre? Apo është se ajo do të jetë një Republika Srpska e re? Realiteti është se nuk mendoj se dikush dëshiron një Republika Srpska tjetër”.

Republika Srpska, një nga dy entitetet që përbëhet nga Bosnja dhe Hercegovina, shpalli pavarësinë në 1992 dhe u njoh zyrtarisht sipas Marrëveshjes së Dejtonit të vitit 1995. Në muajt e fundit, presidenti i saj pro-rus Milorad Dodik është përpjekur të hapë rrugën për shkëputjen e saj nga Bosnja.

Në qershor, ligjvënësit e Republika Srpska votuan për pezullimin e vendimeve të gjykatës kushtetuese të Bosnjës, në një lëvizje të përshkruar nga ekspertët si “shkëputje ligjore” dhe një shkelje e rëndë e Marrëveshjes së Dejtonit. SHBA e dënoi këtë veprim, duke thënë se kërcënonte sovranitetin e Bosnjës.

“Njerëzit në Prishtinë dhe Kurti e kanë bërë shumë të qartë se në komunat autonome shohin Republikën Srpska të re. Dhe ata nuk shohin në atë model një zgjidhje për Kosovën. Ata shohin një version të ri, një gjeneratë të re të krizës për Kosovën, dhe në fund të fundit rajonin në tërësi”, tha Mujanoviç.

I dërguari i Serbisë në Uashington, Duriç,

këmbënguli në deklaratën e tij për CNN se Beogradi ishte i përkushtuar për një marrëdhënie paqësore me Kosovën. “Serbia po punon gjithashtu në mënyrë aktive për të mos përshkallëzuar tensionet me Kosovën shpesh në bashkëpunim me SHBA-në dhe BE-në dhe është e përkushtuar që të sigurojë që Evropa Juglindore të mbetet paqësore”, tha ai.

Kali i gabuar?

Gjatë gjithë muajve të fundit të tensioneve, SHBA dhe BE kanë përsëritur vazhdimisht angazhimin e tyre për kauzën e sjelljes së Vuçiqit në krahun e tyre. Por Serbia ka vepruar me injorim në rritje, duke përfaqësuar atë që Kearns e quajti “një dështim i diplomacisë parandaluese”. Një episod i dëmshëm erdhi në Ohër, në Maqedoninë e Veriut, në mars, kur, pas muajsh negociatash të ndërmjetësuar nga SHBA dhe BE, Serbia dhe Kosova më në fund pranuan një marrëveshje dypalëshe që synonte normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Por, ndërsa kjo u paralajmërua si një përparim, Vuçiq u largua nga negociatat pa e firmosur dokumentin, duke pretenduar në një fjalim televiziv se nuk ishte në gjendje ta bënte: “Kam një dhimbje torturuese në dorën time të djathtë... ajo dhimbje pritet të vazhdojë për katër vite.”

Një tjetër erdhi kur autoritetet serbe arrestuan tre oficerë të policisë së Kosovës, të cilët pretendonin se ishin futur “thellë brenda territorit të Serbisë qendrore” dhe përgatiteshin për të kryer “një akt terrorizmi”. Por Kosova këmbënguli se oficerët ishin “rrëmbyer” brenda kufijve të Kosovës, dhe se Serbia kishte kryer dhe “akt agresioni”.

SHBA dhe BE ishin të ngadalta për të reaguar ndaj këtij incidenti. KFOR-i, Forca e

NATO-s në Kosovë, lëshoi një deklaratë 48 orë pasi oficerët u raportuan të zhdukur. SHBA lëshoi një deklaratë tre ditë më vonë, duke pretenduar se arrestimet u kryen me “akuza të rreme”.

Joseph i tha CNN se rrëfimi serb i ngjarjeve ishte i vështirë për t’u besuar – dhe se formulimi i deklaratës së SHBA-së sugjeronte që zyrtarët e tyre gjithashtu nuk po e hanin atë. “Nëse SHBA-të ishin vërtet të pasigurta nëse policia e Kosovës ndodhej në Serbi, atëherë pse të përdoret një term kaq kategorik [si ‘i rremë’], i cili parandalon kompetencën dhe gjykimin e gjykatës serbe?”

E megjithatë Serbia nuk u ndëshkua për incidentin. Lirimi i oficerëve u sigurua dy javë më vonë – jo nga aleatët perëndimorë, por nga kryeministri hungarez Orban. Pas episodeve të tilla, Joseph i tha CNN se qasja “nuk shohim një të keqe” ndaj regjimit të Vuçiqit mund të ketë filluar të plasaret.

“Pyetja këtu është: Kush në administratën e Bidenit beson ende se Vuçiq është partner?, tha ai, duke vënë në dukje sanksionimin e fundit të Aleksandar Vulin, drejtorit të shërbimit inteligjent të Serbisë, si dëshmi se administrata e Bidenit “nuk është më rob i frikës dhe iluzionin për Vuçiqin”.

Por është ende e paqartë nëse kjo përkthehet në një ndryshim të politikës.

Ndërkohë, Vuçiq e ka rritur stekën. Në përgjigje të sanksionimit të Vulinit, Vuçiq ndaloi eksportet e armëve nga Serbia për 30 ditë, duke pretenduar se “gjithçka duhet të përgatitet në rast agresioni kundër Republikës së Serbisë”. “Ai në thelb thotë ‘ne do të hyjmë në konflikt, duhet të ndalojmë të gjitha eksportet e armëve tani, sepse na duhen për sigurinë tonë kombëtare.’ Ai po kërcënon haptaz me luftë. Unë kurrë nuk e kam parë kaq të qartë më parë”, tha Ruge nga ECFR.

Dhe mesazhi i presidentit është pranuar nga disa qytetarë serbë. Në ndeshjen e futbollit të Yllit të Kuq të Beogradit muajin e kaluar, tifozët nacionalistë serbë mbanin një pankartë ku shkruhej “Kur ushtria të kthehet në Kosovë”. Vuçiq mori pjesë në ndeshje, sipas mediave lokale.

“Është e qartë se kush është ende trazovaçi i Ballkanit”, tha për CNN Meliza Haradinaj, ish-ministre e Jashtme e Kosovës. Koha do të dëshmojë se ky ‘investim’ për të qetësuar Serbinë do të shkojë dëm. / CNN – Bota.al



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave

Përgjegjësitë dhe kompetencat

Bordi për Ankesa shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së, që drejtpërdrejt i nënshtrohen vendimit, sa i përket:

- Dhënies, refuzimit, mosripërtërimit ose revokimit të lejes transmetuese;
- Vënies ose ndryshimit të kushteve të lejes së transmetimit, me përjashtim të kushteve që kanë të bëjnë me caktimin e frekuencave apo kritereve të tjera teknike;
- Shqiptimit të sanksioneve dhe çështjeve tjera të ngjashme, që mbështeten në aktet nënligjore;
- Bordi i Ankesave mund të mbështesë, ndryshojë ose shfuqizojë çdo vendim të KPM-së, duke vepruar sipas ankesës për vendimin përkatës.

Kandidatët për anëtarë të Bordit duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të kenë vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Të kenë së paku diplomë universiteti në fushën e drejtësisë;
- Të kenë provimin e dhënë të judikaturës;
- Të kenë minimum pesë (5) vjet përvojë profesionale në fushën e avokaturës, çështjeve gjyqësore, ligjit administrativ, rregullimin e mediave apo politikën rregullative;
- Të jenë figura eminente, me karakter dhe moral të lartë, paanshmëri e integritet, përkushtim të dëshmuar të administrimit të duhur të drejtësisë;
- Të mos kenë pengesa në kuptim të nenit 39 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.
Kandidatët të plotësojnë dhe nënshkruajnë vetë-deklaratën, që i përmbushin të gjitha kriteret e pranueshmërisë në nenin 39 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar dhe mund të rizgjedhen vetëm edhe për një mandat tjetër.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Letra motivuese;
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës (duke bashkëngjitur edhe raportin nga Trusti pensional);
- Deklaratën e plotësuar dhe të nënshkruar;
- Certifikatën që kandidati nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj).

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 9 tetor 2023, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosova raspisuje:

K O N K U R S

Za izbor dva (2) člana Borda za žalbe medija

Odgovornosti i nadležnosti

Bord razmatra žalbe stranaka protiv odluka NKM-a, koje neposredno podležu odlukama koje se odnose na:

- Izdavanje, odbijanje, ne produžavanje ili oduzimanje dozvola za emitovanje;
- Postavljanje ili izmenu uslova dozvole emitovanja, izuzev uslova koji se odnose na određivanje frekvencija ili drugih tehničkih kriterija;
- Izricanje sankcija i slično, na osnovu pod zakonskih akata.
- Bord za žalbe može podržati, izmeniti ili staviti van snage svaku odluku NKM-a, postupajući prema žalbi protiv određene odluke.

Kandidati za člana Borda moraju ispuniti sledeće uslove:

- Mora biti državljanin Republike Kosova i stalno nastanjen na Kosovu;
- Da imaju minimum univerzitetsku diplomu iz oblasti prava;
- Da imaju položen pravosudni ispit;
- Da imaju najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti advokature, sudstva, uprave, regulisanju medija ili u regulatornoj politici;
- Da su eminentne ličnosti visokog karaktera, morala, integriteta, nepristrasni i dokazano privrženi administriranju pravde;
- Da nemaju prepreka u smislu člana 39 Zakona o NKM;
Kandidati popune i potpišu svoju deklaraciju, da ispunjavaju sve uslove saglasnosti u skladu sa članom 39. Zakona o nezavisnoj Komisiji za medije.

Članovi Odbora za žalbe imenuju se trogodišnjim mandatom uz mogućnost reizbora za samo još jedan mandat.

Uz aplikaciji trebaju se priložiti sledeća propratna dokumenta:

- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o školskom i stručnom obrazovanju (diplome iz stranih univerziteta moraju biti nostrifikovane od Ministarstva za obrazovanje, nauku i tehnologiju);
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu (prilaže i izveštaj od Trusta penzijske štednje);
- Popunjenu i potpisanu deklaraciju; i
- Certifikat da kandidat nije pod istragom (ne starije od 6. meseci).

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 9. oktobar 2023. godine u 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Šampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.

Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.

